REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 271/19
Datë/Datum. 31.05.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: QENDRA E STUDENTEVE

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP

Nr i Prokurimit	**1020890500-19-1786-1-1-1**
Nr i brendshëm	**QS 2019 012 111**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me mobilje per nevoja te konvikteve ne Qender te Studenteve**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.T.G. Blendi
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Gustav Mayer nr.13
(Adresa)

Prishtine
(Vendi)

10.000
(Kodi postar)

038223120
(Numri Telefonit)

/
(Numri i Faks-it)

Shaip Rama- Drejtor
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shtypshkronjablendi@gmail.com
(Adresa elektronike)

31.05.2019.
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi Prishtinë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

/
(Emri i avokatit)

/
(Adresa e plotë)

/ /
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

/
(Adresa elektronike)

/ /
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate eshte publikuar me date : 05.04.2019
Formulari standard per korigjim te noftimit per kontrate: 08.04.2019
Afati i fundit per dorzimin e ofertav: 26.04.2019. ora 12:00
Leter standarte per sqarim te tenderit 02.05.2019
Njoftimi per vendimin e AK (Dhenje te kontrates) 06.05.2019
Leter standarte per tenderues te eliminuar 15.05.2019

Kriter per dhenie te kontrates: Tenderi i pergjegjshem me cmim me te ulet
Te gjitha njoftimet e lartecekura jane publikuar në e-prokurimi.rks-gov.net

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Procesverbalin e hapjes se ofertave e kemi pranuar ne e-prokurim

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

Letren standarde per tenderuesin e eliminuar e kemi pranuar me 15.05.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se. Kerkesen per ri-shqyrtim tek AK e kemi derguar me 20.05.2019. Vendimi per refuzim te kerkeses per ri-shqyrtim eshte leshuar nga AK me 21.05.2019.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1- Qellimi Neni 6- Ekonomiciteti dhe efikasiteti Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo Diskriminimi Neni 28 Specifikimet teknike

Neni 52.3- Njoftimi i kritereve per dhenie te kontrates Neni 59- Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve Neni 18 i Udhezimit operativ- Dosja e tenderit Neni 20 i Udhezimit operativ- Specifikimet teknike Neni 108/a- pika 2 Pezullimi i aktivitetit te prokurimit

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK/Komisioni vlersues gjatë vlersimit të ofertave për tenderin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 perkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhezimin operativ per prokurim publik. AK gjate vleresimit te ofertav per projektin ne fjale nuk ka respektuar dispozitat ligjore te lartecekura, kompania jone nuk eshte trajtuar barabarte me OE tjere pjesmarres. Shkelje esenciale nga AK eshte mosrespektimi i nenit 52.3 te LPP-se pasiqe AK gjate vleresimit te ofertave nuk esht bazuar ne kushtet dhe kriteret e cekura ne njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit por ka perdorur kritere jo te matshme te cilat me pare nuk jane cekur ne njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit, citoj:3. Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Se bashku me oferten tek AK kemi dorezuar deklaraten e specifikimeve teknike me te cilen i kemi garantuar AK se materialet e ofruara per projektin ne fjale jane ne perputhshmeri te plote me specifikimet teknike si ne ANEKS 1 te dosjes se tenderit. Shkelje esenciale nga AK eshte se kompania jone pasiqe eshte shpallur fitues per LOT 4 me ane te njoftimit mbi vendimin e AK-se te dt.06.05. na jane kerkuar mostrat e produkteve para nenshkrimit te kontrates dhe AK ka vendosur per eliminimin e kompanise sone edhe pse mostrat e ofruara jane ne pajtim me kerkesat e AK si ne ANEKS 1 Specifikimet teknike te detyrueshme. Per hire te transparences dhe korrektesise edhe pse dorezimi I mostres nuk ka qene kerkese- kriter ne njofimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit ne kemi dorezuar mostrat tek AK dhe mostrat e dorezuara jane ne perputhje te plote me specifikimet teknike dhe ne harmoni me oferten e kompanise/konzorciumit tone. Edhe ne rast se nuk do te dorezonim mostrat fare AK nuk ka te drejte te eliminoje kompanine tone pasiqe ka vendosur paraprakisht gjate fazes se vleresimit te na rekomandoje fitues me ane te njoftimit mbi vendimin e AK-se dhe leter standard. Eliminimi i kompanise sone pa nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues me ane te cilit njekohesisht duhet njoftuar te gjitha palet pjesmarrese perben shkelje ligjore dhe nuk lejohet me ligjin dhe praktikat e prokurimit prandaj si perfundim ju lutem qe aktivitetin e prokurimit ta ktheni ne ri-vleresim, ankesa e kompanise sone te aprovohet si e bazuar dhe ne ri-vleresim te trajtohemi barabarte me te gjithe OE tjere dhe te shpallet kompania jone fitues per LOT4 me vendimin e dt. 06.05.2019 pasiqe plotesojme te gjitha

kerkesat/kriteret e percaktuara ne njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit si dhe kemi cmimin me te ulet.
AK- zyra e prokurimit gjate vleresimit te ofertave per projektin ne fjale ka shkelur nenin 108/a pika 2 te LPP-se pasiqe nuk ka pezulluar aktivitetin e prokurimit edhe pse ka pranuar sipas afatit ligjor ankesen/kerkesen per ri-shqyrtim nga kompania jone.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasoje e shkeljeve te larteckura nga AK ka ardhe deri te eliminimi i kompanise sone pa te drejte dhe ne kete menyre na eshte mohuar nje fitimi simbolik i paramenduar nga kjo kontrate- lot 4.
Kerkojme nga organi shqyrtues i prokurimit qe pas shoshitjes se provave dhe fakteve per kete aktivitet te prokurimit te aprovoje ankesen tone si te bazuar, lenda te kthehet ne ri-vleresim dhe AK per LOT4 te shpall fituese kompanine/konzorciumin tone pasiqe i plotesojme te gjitha kerkesat dhe kriteret e pershkruara ne njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*